

## Njoftim

Për anulimin e konkursit për pozitën Kryeshef Ekzekutiv dhe Këshilltar i Përgjithshëm/Sekretar i Korporatës në NP "Termokos" Sh.A., Prishtinë.

Bordi i Drejtorëve i NP "Termokos" Sh.A., Prishtinë, në mbledhjen e mbajtur më 16.06.2026, pas shqyrtimit të procedurës së shpalljes së konkursit publik të datës 30.04.2026, me numër protokoll 875, për "Kryeshef Ekzekutiv" dhe "Këshilltar i Përgjithshëm/Sekretar i Korporatës", ka vendosur anulimin e këtij konkursi.

Vendimi për anulimin e konkursit është marrë me qëllim të eliminimit të lëshimeve teknike të identifikuara gjatë procesit të publikimit të konkursit, si dhe për të siguruar zbatimin e plotë të standardeve të transparencës, barazisë dhe korrektësisë procedurale në procesin e rekrutimit.

NP "Termokos" Sh.A. mbetet e përkushtuar që proceset e rekrutimit të zhvillohen në përputhje me legjislacionin në fuqi, aktet e brendshme të ndërmarrjes dhe parimet e trajtimit të barabartë të të gjithë kandidatëve potencialë. Për këtë arsye, konkursi do të rishpallet pas përfundimit të veprimeve të nevojshme administrative dhe teknike që garantojnë zhvillimin e rregullt të procedurës së rekrutimit.

I falënderojmë të gjithë aplikuesit për interesimin dhe mirëkuptimin e treguar lidhur me këtë vendim. Njëkohësisht, i inkurajojmë të gjithë kandidatët e interesuar që të aplikojnë sërish pas rishpalljes së konkursit.

Kandidatët që kanë dorëzuar dokumentacionin e tyre për këtë konkurs ftohen që, sipas nevojës, të tërheqin dokumentacionin pranë administratës së NP "Termokos" Sh.A., Prishtinë.

Për çdo informatë shtesë lidhur me këtë çështje, palët e interesuara mund t'i drejtohen zyrave të NP "Termokos" Sh.A., Prishtinë.

NP "Termokos" Sh.A., Prishtinë

Datë: 16.06.2026